

VEPRIMTARIA DHE ZHVILLIMI I ARKIVAVE NË MAQEDONI NGA VITI 1926-1951

Përmbledhje

Arkivat janë institucione në të cilat ruhet thesari burimor i shkruar, incizuar, krijuar, regjistruar apo në një formë tjetër përmes dokumenteve, shënimeve që kanë të bëjnë me ngjarje të ndryshme. Arkivi ruan përjetësinë e kujtesës shoqërore dhe njerëzimit në përgjithësi dhe është thesar i një shoqërie, kombi dhe vendi, prandaj quhet “Memorie e shoqërisë”. Ky punim trajton çështjet e themelimit, veprimtarisë dhe zhvillimin e arkivave në mënyrë institucionale në Maqedoni si dhe funksionimin e tij në periudha të ndryshme kohore. Pas Luftës së Parë Botërore, duke e parë të arsyeshme zgjerimin e arkivave, mbretëria serbo, kroate, sllovene, me iniciativën dhe ndihmën profesionale nga Arkivi Shtetëror i Beogradit, u formua Arkivi Shtetëror në Shkup më 28 shtator të vitit 1926 i cili funksionoi në fillim me dy të punësuar dhe ishte i vendosur në shtëpinë e drejtorit Delimir Llazareviq. Deri në vitin 1941 Arkivi i Shkupit ishte institucion më vete, pastaj iu bashkëngjiti Muzeut të Serbisë jugore në Shkup. Ndër institucionet e para që kishin grumbulluar lëndën arkivore deri në formimin e arkivave përkatëse në Maqedoni ishin Instituti për Histori Nacionale dhe Fakulteti Filozofik në Shkup. Drejtoria e parë arkivore në Republikën Popullore të Maqedonisë u formua në vitin 1949 dhe Arkivi Historik i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Maqedonisë. Lënda arkivore u ruajt në disa institucione deri më 1 prill të vitit 1951, kur u themelua Arkivi Shtetëror i Republikës Popullore të Maqedonisë.

Fjalët kyçe: *arkiv, institucion, dokument, lëndë arkivore*

Abstract

Archives are institutions in which the source treasure is stored written, recorded, created, recorded or in another form through documents, records related to various events. The archive preserves the eternity of social memory and humanity in general and is a treasure of a society, nation and country, therefore it is called "Society Memory". This paper addresses the issues of establishment, activity and development of archives in an institutional way in Macedonia and its operation in different periods of time. After the First World War, considering the expansion of the archives reasonable, the Kingdom of Serbo, Croatian, Slovenian with the initiative and professional assistance of the State Archives of Belgrade, the State Archives was established in Skopje on September 28, 1926, which functioned at the beginning. with two employees, and was located in the house of director Delimir Lazarevic. Until 1941 the Skopje archive was a separate institution, then it joined the Museum of Southern Serbia in Skopje. Among the first institutions to collect archival material until the formation of the respective archives in Macedonia were the Institute of National History and the Faculty of Philosophy in Skopje. The first archival directorate in the People's Republic of Macedonia was established in 1949, also the historical archive of the Central Committee of the Communist Party of Macedonia. The archive material was stored in several institutions until April 1, 1951, when the state archive of the People's Republic of Macedonia was established. KEY WORDS: archive, institution, document, archival material. then join the Museum of Southern Serbia in Skopje. Among the first institutions to collect archival material until the formation of the respective archives in Macedonia were the Institute of National History and the Faculty of Philosophy in Skopje. The first archival directorate in the People's Republic of Macedonia was established in 1949, also the historical archive of the Central Committee of the Communist Party of Macedonia. The archive material was stored in several institutions until April 1, 1951, when the state archive of the People's Republic of Macedonia was established.

Keywords: *archive, institution, document, archival material*

VEPRIMTARIA DHE ZHVILLIMI I ARKIVAVE NË MAQEDONI NGA VITI 1929-1950

Zhvillimi i veprimtarisë arkivore në Maqedoni ishte në lidhje të pandashme dhe i kushtëzuar me rrugën zhvillimore dhe historike të territorit të Maqedonisë. Maqedonia gjatë shekujve XI, XII dhe pjesërisht në shek. XIII ishte nën sundimin bizantin, në të cilin funksiononte sistemi i atëhershëm juridiko-shoqëror dhe ishte nën organizimin romak-bizantin në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit arkivor. Në kohën e dyndjeve të mëdha të popujve dhe rënien e Mbretërisë Romake, materiali arkivor ruhej në kisha dhe manastire. Në Evropën perëndimore, me zhvillimin e qyteteve, rolin e arkivave zyrtare filluan ta zbatojnë noteritë, ndërsa në Maqedoni kishat dhe manastiret e mbanin të drejtën si institucione publike, “Fides Publica” (besim publik), të paraqitura në rolin e arkivave të manastireve.¹ Me ardhjen e Perandorisë Osmane, sistemi i atëhershëm juridiko-shoqëror u zëvendësua me udhëheqjen shtetërore turke, përveçse në kisha dhe manastire, administrata turke arkivin e ruante te gjykatësit, në xhami dhe në rezidenca. Manastiret edhe më tej e ruanin materialin e rëndësishëm arkivor në arka arkivore, por meqë e humbën të drejtën e “besimit publik”, pushuan së pranuari material arkivor nga jashtë. Dokumentet e tyre arkivore i ruanin më së shumti nga respekti ndaj traditës. Hartat më të vjetra dhe dokumentet e përditshme të cilat për një kohë të shkurtër u asgjësuan për shkak se e humbën rëndësinë aktuale. Për këtë shkak në manastire mund të gjenden vetëm disa dokumente në lidhje me raportet e kishave me Kostandinopojën, harta turke dhe dokumente të cilat flasin për marrëdhëniet me pushtetin turk. Disa hulumtues shkencorë nga hulumtimet e bëra në lidhje me manastiret e Maqedonisë thuhet se kanë hasur në dokumente dhe libra të vjetra, të cilat ishin asgjësuar nga moskujdesi i të punësuarve në manastire, posaçërisht për shkak të frymës antislllovene të pushtetarëve kishtarë grekë. Nga një numër i madh hulumtuesish në lidhje me këtë çështje do të përmendim poetin kroat si dhe konsull i Austrisë në Selanik, Antun Mihanoviç, i cili kishte sjell koleksion të librave në Zagreb. Asgjësim më i madh kishte ndodhur nga ndikimi i madh i propagandës së huaj në Maqedoni dhe luftërave, të cilat kryesisht zhvilloheshin në Maqedoni deri në vitin 1918. Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore dhe copëtimit të Maqedonisë, në mënyrë të organizuar ruhet materiali arkivor në pjesën e Maqedonisë së Vardarit, sot Republika e Maqedonisë së Veriut.

Duke e parë nevojën për shtrirje të shërbimit arkivor në tërë hapësirën e mbretërisë serbo, kroate dhe slllovene, shërbimet përkatëse filluan

¹ Државен архив на Република Македонија (1951-2016), бр. 9

formimin e qendrave arkivore, përveç atyre që ishin në funksion, në shtetin e porsa formuar. Kështu që me iniciativë dhe ndihmë profesionale nga Arkivi Shtetëror i atëhershëm në Beograd, konkretisht Odaviç, në përfundim të vitit 1925 kishte për obligim të udhëtojë drejt Novi Sadit dhe Shkupit dhe atje të sigurojë vend për themelimin e arkivit. Ai këtë e kishte bërë dhe me propozim të tij arkivit iu nda buxheti për vitin 1926-'27.² Me siguri që udhëtimi i parë i tij kishte vetëm karakter informativ, me qëllim të vendosjes së rrjetit që të gjendet materiali arkivor, e që rezultatet kryesore shihen në maj të vitit 1926. Meqë kushtet në terren lejonin ekzistimin e një arkivi në Shkup, u formua Arkivi Shtetëror në vitin 1926.

Institucioni i parë arkivor me detyrë që të mbledhë, rregullojë dhe përpunojë materialin arkivor ishte formuar më 28 shtatorë të vitit 1926 në Shkup. Arkivi Shtetëror në Shkup në fillim ishte vendosur në banesën private të drejtorit Delimir Llazareviq, profesor në Gjimnazin e Shkupit, kurse shërbyes civil ishte Stoilko Neshiç nga fshati Kuçevisht. Në fillim udhëheqësi ishte i detyruar ta fillojë veprimtarinë duke e mbledhur materialin arkivor në banesën private, ndërsa në prill të vitit 1927 çështja e vendosjes së materialit arkivor, respektivisht të Arkivit Shtetëror në Shkup, ishte zgjidhur përkohësisht në tri hapësira të shtëpisë së arsimit, edhe pse nuk i plotësonte as kushtet minimale. Gjithë materiali arkivor nuk mund të vendosej në një dhomë dhe për këtë Llazareviç iu drejtua dekanit të Fakultetit Filozofik, Petru Kolendiçit dhe kërkoi që arkivi të vendoset në hapësirat e fakultetit, por edhe këtu nuk ia arriti. Problemi vazhdon. Me buxhetin e vitit 1930 Llazareviç shpresonte se është një hap përpara dhe do ta zgjidhë problemin me hapësirën. Ai në këtë vit hapi shpalljen në “gazetën e Shkupit”, ku kërkonte shtëpi me gjashtë hapësira apo dhoma. Kësaj shpallje iu përgjigj Todor Sendoviç nga Shkupi, i cili e afroi ndërtesën e tij me tetë hapësira, por nuk u arrit marrëveshje. Më 26 prill të vitit 1930, Llazareviç arriti marrëveshje me Dordom Parkaçeviç, avokat në Shkup. Në vitet 1931-'34 arkivi kishte siguruar edhe tri hapësira në shtëpinë e Nexhmije Hakiut dhe kështu kishte funksionuar deri në momentin kur iu bashkëngjit Muzeut të Serbisë jugore në vitin 1941. Arkivi ishte filiale e Arkivit Shtetëror të Serbisë me seli në Beograd dhe kishte detyrë të mbledhë fonde arkivore dhe dokumente nga territori i Maqedonisë.

Kjo punë e mundimshme kishte vijuar deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, saktësisht deri në vitin 1941. Arkivi Shtetëror në Shkup udhëhiqej nga ligjet dhe dispozitat që vlenin për Arkivin Shtetëror të Beogradit

² Nedzat Jasar, *Arhivist, Organ Saveza Arhivskih Radnika*, Beograd, 1954, 6p. 90-94

të cilët rrjedhin që nga viti 1898. Në bazë të këtyre akteve ligjore ishte formuar këshilli që e udhëhiqte punën e arkivit.³

Në fillim të punimeve qëllimi i këtij arkivi ishte që ta mbledhte materialin arkivor nga pushtetet e mëhershme të cilët qeverisnin Maqedoninë. Për shkak të mungesës së hapësirave, njohuritë profesionale të punësuarve nuk lejonin që arkivi ta shtrijë veprimtarinë dhe të tubojë materiale arkivore. Në intervalin kohor nga viti 1918-1941 arkivi nuk kishte pranuar material arkivor nga regjistraturat të cilat ekzistonin, por edhe nuk i interesonte fati i tij, respektivisht i materialit arkivor i cili krijohet nga ato regjistratura. Si pasojë e kësaj situate, si trashëgimtarë të veprimtarisë arkivore i pranuan fondet nga qeverisja bullgare 1915-1918, materialet nga qeverisja turke në Maqedoni deri më vitin 1912 etj. Edhe sot nuk kemi asnjë fond të plotë nga qeverisja mes dy luftërave botërore. Një pjesë e materialit arkivor me karakter diplomatik, kulturor dhe fetar i ishte dhënë në vitin 1929 Arkivit Diplomantik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë në Beograd i cili edhe sot nuk është i kthyer në Arkivin e Maqedonisë.

Arkivi shtetëror si organ i mëvetësishëm me seli në Shkup ekzistoi deri në vitin 1941 i cili iu kishte bashkangjitur “Muzeut të Serbisë jugore”, në cilësinë e njësisë së muzeut. Institucionet e para që merreshin me mbledhjen e materialit arkivor, deri në formimin e shërbimit arkivor në Maqedoni, ishin Fakulteti Filozofik dhe Instituti Nacional i Historisë në Shkup. Shërbimi arkivor nga viti 1941-1949 në Maqedoni nuk kishte ndryshuar, respektivisht nuk ishte freskuar. Në kohën e qeverisjes së Maqedonisë nga Bullgaria, Italia-Shqipëria në periudhën nga viti 1941-1944 jo vetëm që nuk ishte formuar shërbim arkivor, por materiali arkivor për historinë e Maqedonisë ishte bartur te shtetet e lartpërmendura⁴. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe pas vënies së themeleve të shtetit të Maqedonisë ishte paraqitur nevoja e renovimit të punës së Arkivit Shtetëror të Shkupit dhe ishin bërë hapat e parë për organizimin e shërbimit arkivor në Maqedoni. Për këtë qëllim Ministria Popullore për Arsim e Maqedonisë, me vendim, në vitin 1945 dhe 1946, kishte formuar komisione profesionale për mbledhjen e materialit arkivor. Për shkak të sasisë së madhe të materialit arkivor nëpër regjistratura i cili ishte në gjendje të parregulluar, as këto aksione nuk ishin të suksesshme. Për rregullimin e veprimtarisë arkivore dhe materies e cila ka të

³ Одборот го сочинувале членовите: Витомир Вилановиќ, велики жупан во Скопје; митрополитот Варнава; проф. Д-р Петар Колендиќ, декан на филозофскиот факултет во Скопје; Трајановиќ, претседател на апелационит суд во Скопје; Сапунџиќ, претседател на општина Скопје; Зечевиќ, командант на III армиска област во Скопје; Александар Велиќ, Тихомир Ѓорѓевиќ, Радослав Ѓуриќ, Мита Костиќ и Павловиќ

⁴ Државен архив на Р. Македонија, Македонски архивист, Скопје 1981, бр. 5, 6, 7

bëjë me mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e materialit arkivor, më 18 korrik të vitit 1946 në Republikën Popullore të Maqedonisë ishte formuar komision nga tre anëtarë për mbledhjen e materialit arkivor në përbërje: Pero Korobar, Dimçe Koco dhe Mane Çučkov, me qëllim që të afirmohet veprimtaria arkivore, ku disa individë kishin shkruar edhe në gazetën ditore “Nova Makedonia”.

Drejtorja e parë arkivore në Maqedoni u formua në qershor të vitit 1949. Detyrat e arkivit ishin të kufizuara në mbledhjen dhe përpunimin e materialit dhe memoareve arkivore për veprimtarinë e punëtorëve, për historinë e Partisë Komuniste të Maqedonisë si dhe për revolucionin socialist në Maqedoni.

I. 1. Informatë në lidhje me fillimin e punës të Arkivit Shtetëror të Shkupit⁵

Në periudhën e mbretërisë serbe, kroate dhe sllovene, udhëheqësi i arkivit shtetëror, Delimir Llazareviq, më 23.09.1926 i drejtohet Ministrisë së Arsimit - Njësia e Përgjithshme Beograd, të cilën e informon në lidhje me fillimin e punës së Arkivit Shtetëror dhe për kushtet fillestare. Ai e përshkruan këtë ngjarje si në vijim: Ndihem i nderuar t’ju informoj që e fillova punën përkohësisht në banesën time në rrugën “Novosadska”, nr. 1, meqë Kolo me motrat serbe do të kalojë në shtëpinë e tij, ashtu që zyra e deritanishme e cila gjendet në shtëpinë e arsimit, do të lirohet për Arkivin Shtetëror rreth 15 tetorit të këtij viti.⁶

I. 2. Informatë deri te Ministria e Besimit Fetar në lidhje me mënyrën e grumbullimit të materialit arkivor⁷

Varësisht nga sunduesit, materiali arkivor, në mungesë të institucioneve përkatëse, është grumbulluar dhe ruajtur te gjykatësit, në xhami, rezidenca, më saktësisht gjatë sundimit osman, ndërsa gjatë sundimit bizantin është ruajtur në kisha, manastire e noteri. Udhëheqësi i Arkivit të Shtetit, Delimir Llazareviq, më 27.09.1926 i drejtohet Ministrisë së Besimit Fetar përmes Ministrisë së Arsimit në lidhje me grumbullimin e materialit arkivor. Kam nderin që t’ju lus, meqë në Shkup është themeluar Arkivi Shtetëror dhe që udhëheqësit e manastireve dhe kishave duhet t’i dalin në ndihmë arkivit dhe t’i japin me revers dokumentet e vjetra që i kanë në shqyrtim.⁸

⁵ Dokumenti origjinal është në gjuhën serbe

⁶ ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр. 1.337.3.7/327

⁷ Dokumenti origjinal është në gjuhën serbe

⁸ ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/328

I. 3. Informatë e Arkivit Shtetëror deri te kryetarët e bashkisë në lidhje me grumbullimin e materialit arkivor⁹

Si nevojë e domosdoshme që të bëhet grumbullimi i materialit arkivor, pa marrë parasysh gjendjen e tij, duke u bazuar në informatën e Arkivit Shtetëror me nr. 51, dërguar kryetarëve të bashkisë, ku në lidhje me këtë informatë kryepeshkopi i rrethit të Velesit, drejtohet deri te gjykatat komunale.

“Kam nderin t’ju lus të urdhëroni, të dërgoni deri te të gjitha pushtetet e rrethinës së kryetarëve të bashkisë që ju është besuar, Arkivit Shtetëror të Shkupit, ku si detyrë e tyre është mbledhja, ruajtja e dokumenteve arkivore të cilësdo kohë qofshin, pa marrë parasysh vlerën e tyre, gjuhën si dhe territorin e tërë Serbisë jugore e vendosur në shtëpinë e atëhershme të arsimit, ku për të gjitha informatat dhe njoftimet që i japin pushtetet duhet t’i drejtohen Arkivit Shtetëror i cili është i vendosur në shtëpinë e arsimit”.¹⁰ Kjo dërgohet deri te gjykata në prefekturën përkatëse duke e ditur dhe vepruar në lidhje me të.

I. 4. Lutje për punësimin e nëpunësve në Arkivin Shtetëror në Shkup¹¹

Udhëheqësi i arkivit shtetëror, Delimir Llazareviq, më 16.08.1927, i drejtohet Ministrisë së Arsimit, Njësia e Përgjithshme - Beograd, për punësimin e nëpunësve për të vetmin qëllim: grumbullimin dhe rregullimin e materialit arkivor.

“Me aktin nr. 49 nga 8 prilli, kishte lutur ministrin që t’i dërgonte në punë në Arkivin Shtetëror zotërinjtë Sergejlin dhe Viktor Petrovin, si nëpunës administrativë të punësuar në gjimnazin e meshkujve. Ministria me shkresë nr. 1028 i ishte përgjigjur, që Arkivit nuk mund t’i jepen në shërbim këta dy nëpunës, sepse kjo do të ishte në dëm të arsimit, edhe pse unë isha marrë veshë me drejtorin e gjimnazit, zotëri Jovanoviç, dhe me lejen e tij e kisha dorëzuar shkresën, ku kjo ishte përmendur edhe në akt”.¹² Ai përsërit lutjen, vetëm se me ndryshim, se në rast se nuk mund t’i lejojë të dy nëpunësit, atëherë njërit t’i lejohet puna në arkiv, sepse është e pamundur që vetë të kryejë kaq punë të madhe rreth rregullimit të arkivit. “Arkivin që fillova ta rregulloj ishte i vendosur në 12 arka të mëdha. Nuk është e mundur të rregullohet nga një person, në një dhomë nga numri i madh i akteve. Menjëherë pas kthimit tonë në vend arkivi, i

⁹ Dokumenti origjinal është në gjuhën serbe

¹⁰ ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр. 1.337.3.7/329

¹¹ Dokumenti origjinal është në gjuhën serbe

¹² ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр. 1.337.3.7/329-330

cili ishte i vendosur në një vagon, i ishte besuar drejtorit që ta rregullojë me disa mësimdhënës dhe banorë vendas, por ata nuk mund ta rregullojnë sepse ai material arkivor është në sasi të madhe, ndërsa pa pagesë shtesë nuk mund të rregullohet. Arkivin në shumë raste e kishin rregulluar, po në vend se të rregullohej lënda arkivore, bëhej çrregullim më i madh. Arkivi ishte sjell nga hapësira, bodrume të lagështa me myk, ku në lëndën arkivore jo që vërehej vetëm lagështia, por edhe shenja të ujit. Përveç kësaj nuk duhet të mos përmenden pluhuri, insektet, papastërtia të cilat edhe më shumë i rëndonin arkat e papastra. Në këtë mënyrë lënda arkivore edhe më shumë ishte përzier si dhe ishte krijuar gjendje kaotike. Edhe pse është dëmtuar shumë, është marrë një pjesë e dokumenteve, sepse shumë kuti arkivore dhe dosje kishin ngelur pa akte, por materiali arkivor ka rëndësi për ne. Edhe po të na kishin ngelur vetëm raportet sekrete politike, përsëri edhe kjo do të kishte domethënie për ne, por ne në këtë arkiv e kemi tërë dokumentacionin e dalë nga puna e peshkopit bullgar dhe të mitropolitanëve të cilët nuk merreshin shumë me kishën, por me politikën dhe ushtrinë. Pastaj në tërësi kemi dokumentet e punës së agjentëve tregtarë bullgarë të cilët rastësisht punonin me tregti, ndërsa si qëllim e kishin propagandën. Kemi shumë akte nga arkivi i vjetër bullgar si, për shembull, Danev, Rizov etj. Në duar kemi një sasi të madhe të arkivit të kohës së Turqisë, por ajo nuk ka aq rëndësi, sepse në një mënyrë ishte bartur në Kostandinopojë. Konsideroj që në interesin tuaj shkencor e politik është ky arkiv. Në rast se ruhet edhe më tej, rregullohet, është i rëndësishëm sepse nga ai shihet kryqëzimi i forcave nën regjimin turk dhe i gjithë kontributi i kësaj beteje dhe fitorja juaj në këtë betejë të pabarabartë. Për këtë shpresoj që kësaj radhe ministria nuk do ta refuzojë lutjen dhe një nga të lartpërmendurit menjëherë do ta dërgojë në punë në Arkivin e Shtetit”.

I. 5. Informatë deri te Njësia për Arsim nën udhëheqjen e kryetarit të bashkisë për rrethinën e Shkupit, që të formohet dhe të punojë Arkivi Shtetëror në Shkup si dhe për fondet e arkivit

Në periudhën e mbretërisë serbo, kroate dhe sllovene, kryetari i bashkisë për rrethinën e Shkupit, Njësia për Arsim Shkup, informohet nga udhëheqësi Delimir Llazareviq në lidhje me aktin e njësisë nr. 6149, datë 30.09.1929. Në mes të tjerave paraqet institucionin që i është besuar e që quhet Arkivi Shtetëror në Shkup, ndërsa veprimtaria dhe puna e tij është që të përfshihen të gjitha territoret e porsaçliruara, në jug nga kufiri i vjetër i mbretërisë së Serbisë. Arkivi u themelua më 28 shtator të vitit 1926, me detyrë që t'i grumbullojë, ruajë dhe t'i rregullojë dokumentet që janë me rëndësi për territorin e lartpërmendur. Të gjitha pushtetet nga

vendet kryesore të bashkësive si dhe të gjithë udhëheqësit e komunave u thirrën dhe i dërguan materialet më të rëndësishme arkivore me të cilat ata kishin, përveçse një pjesë e madhe e materialit arkivor ishte asgjësuar nga armiqtë apo nga njerëz tanë duke mos ditur për rëndësinë e dokumenteve. Por pjesa më e madhe e dokumenteve arkivore janë ruajtur në Shkup dhe në momentin që u adaptuan në hapësira zyre, i tërë materiali arkivor nga territori i bashkësisë u dërgua këtu, sepse ai nuk është vetëm material arkivor për Shkupin, por për tërë banovinën e emëruar. Përveçse e ruan dhe rregullon, detyrë kryesore e arkivit është që materialin arkivor ta rregullojë që të mund të shfrytëzohet për qëllime shkencore. Në këtë fushë ishte përpunuar si në vijim: nga i ashtuquajturi material diplomatik;

nga viti 1902	4 lëndë
1903	19
1904	7
1905	6
1906	6
1907	6
1908	22
1909	16
1911	3

Korrespondencë të besueshme nga viti 1903 - 2 lëndë

1904	1
1907	3
1908	1
1910	1
1911	12
1912	12

Gjithsej 130 lëndë me 2 654 fleta.

Deri më tani asgjë nuk është publikuar edhe pse janë përpunuar për publikim 16 lëndë me 1 126 faqe. Arkivi ka edhe bibliotekën e librave me 264 ekzemplarë (115 numra në bazë të katalogut), por kjo është dytësore për arkivin. Arkivi ka edhe 9 ekzemplarë, libra të vjetra në gjuhën serbe, të cilat kanë vlerë për studime të karakterit gjuhësor, gjeografik dhe historik. Numri i përgjithshëm i lëndëve të përpunuara është 201 me 12 692 fleta në bazë të regjistrit. Arkivi ka mjete buxhetor nga 34 000 dinarë, në pajtim me buxhetin shtetëror të vitit 1929/30. Përveç fondeve të lartpërmendura, është përpunuar arkivi i egzarkisë që i përfshinë rrethet e Shkupit, Tetovës dhe Gostivarit me 70 lëndë e me 5570 fleta.

I. 6. Protokoll për pranim-dorëzimin e arkivit të ish-Agjencisë Bullgare dhe Konsullatës në Shkup

Parim kryesor i çdo arkivi është që ta mbledhë lëndën arkivore, që të realizohet ky parim në prani të komisionit që e kishte emëruar zotëri ministri për arsim me vendim Proc. nr. 20 nga 7 dhjetor të vitit 1929 në përbërje: Dr. Rad. M. Gjuriq, profesor në universitet, dr. Mit Kostiq, profesor në universitet dhe Adamoviq, sekretar në ministrinë për punë të jashtme. U realizua protokollin për pranim-dorëzimin e arkivit të ish-Agjencisë Bullgare dhe Konsullatës në Shkup.¹³ Komisioni u takua më 10 dhjetor të vitit 1929 në ndërtesën e arkivit shtetëror në Shkup dhe në takimin e tyre të parë konstatuan si në vijim:

1. Në pyetjen e parashtruar deri te zotëri Delimir Llazareviq, udhëheqës i Arkivit Shtetëror, se si ishte marrë arkiva bullgare, ai e dha përgjigjen si në vijim: “Materialin arkivor që e ka sot Arkivi Shtetëror në Shkup e gjeta në bodrumin e ndërtesës së bashkisë së Shkupit në fillim të vitit 1929. Edhe pas gjetjes së materialit arkivor nuk m’u lejua që ta marr menjëherë, por më vonë, kur Arkivi Shtetëror i porsaformuar u pajis me hapësira të reja. Materialin arkivor e pranova me revers, të cilin ia dorëzova kryebashkiakut, zotëri Vildoviq. Rregullimin e materialit arkivor e fillova menjëherë, ashtu që deri më sot e kam rregulluar pjesën më të madhe. Nga kur e gjeta materialin arkivor deri më sot askush nuk u shërbye dhe nuk është publiku asnjë e dhënë për të. Përveç që materialin arkivor ia dorëzova zotëri Adamoviqit, kryetar i Ministrisë për Punë të Jashtme, në pajtim me vendimin e Ministrisë së Arsimit, nuk kam më shumë asnjë material arkivor për çfarë flet vendimi i zotërisë ministër i Arsimit, proc. nr. 20”.

2. Pas këqyrjesh së përgjithshme të materialit arkivor është konstatuar që ai ishte rregulluar në bazë të viteve, por vetëm që ishte ruajtur në mënyrë fragmentare, meqë ishte shumë i dëmtuar. Në këto materiale nuk u gjetën materialet e vjetra bullgare, në bazë të të cilave mund të konstatohet se sa ai fond ishte i paplotësuar.

3. Vendoset që menjëherë të fillohet puna, përkatësisht regjistrimi dhe njëkohësisht t’i dorëzohet materiali arkivor zotëri Adamoviqit. Komisioni për herë të dytë u takua më 20 dhjetor të vitit 1929 dhe konstatoi që zotëri Delimir Llazareviq, udhëheqës i Arkivit Shtetëror në Shkup, dhe bashkë me zotëri Adamoviq, sekretar në Ministrinë për Punë të Jashtme, e përpunuan listën e parashtruar. Komisioni në këtë rast konstatoi që edhe më tej në Arkivin Shtetëror në Shkup gjenden edhe materialet arkivore:

¹³ ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр. 1.337.3.7/331

- Arkivi i mitropolit të vjetër bullgar në Shkup. Ky material arkivor ka karakter politik sepse në përgjithësi përmban akte që kanë të bëjnë me propagandën e ekzarkisë bullgare në Maqedoni. Materiali arkivor është i parregulluar dhe i përzier me akte të tjera.

- Materiali i disa komunave bullgare në vilajetin e Shkupit. Edhe ky material arkivor është i parregulluar. Përmban aq akte dhe dokumente sa fondi i tjetër me vlerë historike. Në masë më të madhe janë aktet nga periudha e okupimit bullgar¹⁴ në Maqedoni.

- Materiali arkivor i komandave ushtarake bullgare. Numri më i madh i këtyre dosjeve nga ky arkiv janë të lidhura në mënyrë mekanike, por prapë nuk mund të thuhet që ai fond është i rregulluar. Ky arkiv përmban shumë urdhëresa të rëndësishme ushtarake dhe dokumente.

I. 7. Informatë nga Drejtoria Mbretërore e Bano Vinës së Vardarit për shfuqizimin e Arkivit Shtetëror të Shkupit¹⁵

Ministria për Arsim, Njësia e Përgjithshme Beograd, me urdhër të udhëheqësit të Njesisë së Arsimit, Lub. M. Aleksiq, më 14 korrik 1939, urdhëron Drejtorinë Mbretërore të Bankës së Bano Vinës së Vardarit, Shkup, që arkivi ta mbarojë funksionin që kishte që nga shtatori i vitit 1926. Drejtorisë Mbretërore të Bankës i bie të propozojë që Arkivi Shtetëror në Shkup të mbarojë së funksionuari dhe i tërë materiali arkivor, pasuria e tij, t'i jepet Arkivit Shtetëror të Beogradit.¹⁶ Mbyllja e kësaj drejtorie propozohet duke u bazuar në këto arsye:

1. Arkivi Shtetëror në Shkup nuk ka më dokumente të rëndësishme, sepse gjithçka që ishte me vlerë, para se të themelohet si drejtori, gjendej apo më pas ishte dërguar në Beograd.

2. Arkivi Shtetëror i Shkupit asgjë nuk kontribuoi për zhvillimin e punës shkencore në Serbinë e jugut, por edhe nuk mundet sepse këtë punë tash ka filluar ta organizojë dhe ta udhëheqë Fakulteti Filozofik në Shkup.

3. Puna e tërësishme e kësaj drejtorie mbështetej në dhënien e kompetencave për udhëheqësin dhe nëpunësin (në përgjithësi dy të punësuar nga buxheti), sepse në bazë të librit të protokollit asnjëherë nuk kishte më shumë se 120-130 numra brenda vitit. Këtë vit, për shembull, akti i fundit është regjistruar më 10 korrik dhe bart numrin 77.

¹⁴ Ka të bëjë me periudhën e Luftës së Parë Botërore (1915-1918)

¹⁵ Dokumenti origjinal është në gjuhën serbe

¹⁶ ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/332

4. Nga qershori i vitit 1938 kjo drejtori mbeti pa udhëheqës, i cili u emërua drejtor i Gjimnazit II Mashkullor në Shkup dhe për momentin arkivi ka vetëm një të punësuar.

5. Kursimi i materialit i cili do të arrihet me mbylljen e kësaj drejtorie, do të mund të ndihmojë në rritjen e personelit dhe mjeteve materiale për nevojat e arsimit në shkollat e mesme.

I. 9. Thirrje për tubimin e materialit arkivor dhe formimin e arkivit të Lëvizjes Popullore Çlirimtare

Ministria e Arsimit, e përfaqësuar nga delegati për arsim, N. Minçev dhe presidiumi i KAÇPM-së, më 03.05.1945 bënë thirrje - deri te shtabi kryesor i Armatës Jugosllave për Maqedoni - për tubimin e materialit arkivor dhe formimin e arkivit të Lëvizjes Popullore Çlirimtare. Në rrjedhën historike të veprimtarisë shoqërore në të cilën kaloi populli ynë, janë humbur shumë dokumente të rëndësishme për të gjithë ata që merren me shkrimin e historisë së Maqedonisë. Ajo në veçanti vlen për betejat revolucionare të mëhershme të popullit tonë, nga të cilat mbetën vetëm pak dokumente të shkruara.¹⁷ Që të mos ndodhë e njëjta edhe me epokën e Luftës Popullore Çlirimtare, Ministria e Arsimit mendon se duhet të krijohet një arkiv i Lëvizjes Popullore Çlirimtare, në të cilin duhet të mblidhen, radhiten dhe të vihen në dispozicion të gjitha dokumentet dhe materialet e Luftës Popullore Çlirimtare të Historianëve. Një institut i tillë do të ishte Biblioteka Popullore në Shkup, ku do të krijohej një njësi e veçantë për këtë punë. Në këtë arkiv duhet të tubohen të gjitha librat, revistat, gazetatat e shtypura, litografike, të shkruara me dorë; të gjitha manifestimet, fotografitë; të gjitha hartat, urdhëresat, instruksionet; të gjitha kujtimet e shkruara të dëshmitarëve të gjallë për ushtarët e rënë; letra e në përgjithësi çdo dokument i cili ka të bëjë me Lëvizjen Popullore Çlirimtare. Që të arrihet e gjithë kjo, Ministria mendon që të bëhet si në vijim:

1. Të shkruhet historia e çdo njësie, kur dhe me çfarë shkalle arsimit është njësia, kush kishte qenë komandant dhe komisar politik me tre emrat; data dhe vendi i lindjes; një përshkrim i shkurtër i jetës së tij;
2. Veprimtaria e njësisë, kur, ku dhe çfarë aksione kishte kryer njësia;
3. Listë për të gjithë luftëtarët nga njësia, tre emrat, data dhe vendi ku ka lindur dhe si ka ardhur në njësi;
4. Si ka funksionuar njësia kur nuk kanë qenë në aksion, me çfarë merreshin ushtarët, si është bërë përgatitja politike, arsimore e ushtarëve; si ishte i organizuar ushqimi; çfarë armatimi kishte;

¹⁷ ДАРМ, Ф. Министерство за просвета на НРМ, бр. 1.170.8.55/340

5. letrat e ruajtura, në rast se nuk i përmbajnë këto të dhëna, në një fletë të veçantë të shënohen: nga kush dhe deri ku u adresua letra, data apo koha e përafërt dimër, verë, para përfundimit të dimrit, në fillim të verës, para pashkëve etj.;

6. Thirrjet, fotografitë, afishet, kur janë dhënë dhe me çfarë arsye, si janë përpunuar, kush kishte marrë pjesë gjatë përpunimit, kush dhe si i kishte dërguar dhe përhapur;

7. Gazetat, kur filluan të shtypen, kush i redaktoi, kush ishin bashkëpunëtorët, si, ku dhe kur ishin redaktuar dhe shumëzuar në çfarë numri dhe si erdhi deri te materialet;

8. Të bëhet e pamundura që të gjithë luftëtarët, ofensivat, veprimtaritë, e tërë jeta e njësisë apo brigadës të shkruhet në formë të memoareve;

9. Të bëhet listë për të gjithë luftëtarët e rënë, nga ishin si dhe kur dhe si kishin rënë. Duke e ditur rëndësinë e kësaj pune, Ministria Popullore e Arsimit e lutë shtabin qendror, që t'i kushtohet vëmendje kësaj pune dhe t'u sugjerojë të gjithë luftëtarëve të gjallë partizanë, që t'i përgatitin memoaret dhe në rast se kanë dokumente dhe fotografi, t'i dorëzojnë.

Ligje:

Закон за архивски материјал, бр. 95/2012

Прави лникз авнатреш на организација, бр. 01-2596/1 од 09.08.2016.

Burime arkivore:

ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/327

ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/328

ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/329

ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/329-330

ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/331

ДАРМ, ф. Државна архива-Скопје, бр.1.337.3.7/332

ДАРМ, Ф. Министер ство за просветана НРМ, бр.1.170.8.55/340.

Literatura:

Државенархивна Република Македонија, 1951-2016

Jasar, Nedzat, *Arhivist*, Organ Saveza Arhivskih Radnika, Beograd, 1954

Osmani, Jusuf, *Arhivistika - teoria dhe praktika*, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 2005

Р. Македонија, Државенархивна, *Македонскиархивист*, Скопје 1981

